



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 4002 Më 08.12.2025
Br. prot. Dt. 25
RAHOVEC - ORAHOVAC

Thirrje për shfrytëzimin e Shtandeve Mobile të Drurit

Qëllimi

Komuna e Rahovecit, hap thirrjen publike për dhënen në shfrytëzim të shtandeve mobile. Shtandet jepen në shfrytëzim për persona fizik dhe juridik. Bizneset e përzgjedhura do të ofrojnë produkte gastronomike dhe shërbime me tematikë dimërore dhe turistike.

Vendi:

- Thirrja do të jetë e hapur nga data 08.12.2025 nga ora 08:00 deri më 11 dhjetor 2025 në ora 16:00.
- Hapja e ofertave do të bëhet me datë 12.12.2025 në ora 13:30, salla e K. Komunal
- Periudha e shfrytëzimit nga 15.12.2025 deri më 15.01.2026
- Bizneset duhet të operojnë çdo ditë nga ora 12:00 – 23:00
- Hapja pas orës 12:00 sjell humbjen e të drejtës së shfrytëzimit të shtandit.
- Përzgjedhja e përfituesëve bëhet nga komisioni komunal.
- Numri i shtandeve është i kufizuar.

Kriteret

- Përfituesit e shtandeve menjëherë pas përfitimit nga kjo thirrje janë të obliguar të bëjnë dekorimin e shtandit përfitues dhe hapësires për rreth.
- Bizneset duhet të jenë të regjistruara në ARBK dhe të veprojnë në **Komunën e Rahovecit**.
- Lejohen vetëm artikujt e miratuar në aplikim.
- Detyrim për vendosjen e shportave të mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë.
- Lokacionet e shtandeve -Sheshi Qendror në Rahovec

Përparësitë në Përzgjedhje

Përparësi do të kenë bizneset që:

- Promovojnë produkte **vendore/lokale**.
 - Ofron produkte ushqimore **inovative** ose me motive dimërore/festive.
-

Kritere Objektive për Përzgjedhje

- Produkte vendore/tradicionale.
 - Brendim i rregullt dhe imazh profesional.
 - Produkte inovative me motive festive.
 - Përvojë në aktivitete turistike ose panaire.
 - Koncept festiv i qartë dhe i realizueshëm.
-

Kodi i Mirësjelljes dhe Obligimet Shtesë

Bizneset janë të obliguara të tregojnë bashkëpunim të mirëfilltë.

Rreptësisht ndalohet:

- Kryerja e veprave të paligjshme ose akteve të dhunshme.
- Abuzimi verbal ose fizik ndaj personave.
- Shitja e produkteve që nuk janë paraparë në aplikim.
- Mosmbajtja e pastërtisë brenda dhe jashtë shtandit.

Mënyra e Aplikimit

Dokumentet e plotësuara, dorëzohen vetëm në kopje fizike, në sportelet e Komunës së Rahovecit

Dokumentet e domosdoshme

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit (me veprimtari);
- Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
- Vërtetimi i taksave komunale;
- Vërtetimi i tatimit në prone për personat fizik.

Aplikuesit që ofrojnë ushqim dhe/ose pije duhet të paraqesin menynë përkatëse.

Rregulla të aplikimit

- Lejohet vetëm **një aplikim për një person fizik ose juridik.**
- Aplikuesi duhet të jetë **pronar i biznesit.**

Afati i Aplikimit

08/12/2025 – 11/12/2025

Ora: 08:00 deri 16:00

Vend: Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Rahovec

Çdo aplikim duhet të protokollohet me emërtimin:

“Kërkesë për shfrytëzimin e Shtëpizave për Festat e Fundvitit”.

Pas shqyrtimit, kandidatët do të njoftohen për nënshkrimin e kontratës.

Vërejtje

Biznesi që fiton të drejtën e shfrytëzimit **nuk ka të drejtë të nënkontraktojë** ose të bëjë marrëveshje me ndonjë biznes tjetër për operim. Në të kundërt, kontrata ndërpritet.